

Irena Islami



Përgjegjëse e Sektorit të Kërkimit Shkencor, pranë Departamentit të Kërkimit Shkencor në KLSH.

Lindur në vitin 1959. Diplomuar në Shkencat e Tokës(1985).

Ka kryer studimet universitare në Francë. Ne vitin 2008 ka përfunduar Master në Administrim Biznes, Universiteti Bordeaux IV, në bashkëpunim me Universitetin Politeknik të Tiranës.

Ka 30 vjet eksperiencë pune, nga të cilat një vit e gjysmë në KLSH.

Fusha e ekspertizës: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore.

Armanda BEGAJ

Drejtoreshë në Departamentin e Kërkimit Shkencor dhe Zhvillimit në KLSH.

Lindur në vitin 1968. Diplomuar në Matematikë(1991).

23 vite eksperiencë pune.

12 vite specialiste e Teknologjisë së Informacionit në KLSH.

Prej tre muajsh e komanduar Drejtoreshë në Departamentin e Kërkimit Shkencor dhe Zhvillimit në KLSH.

Fusha e ekspertizës: Teknologjia e Informacionit



KONTRIBUTI I KLSH NË KËRKIMIN SHKENCOR TË APLIKUAR TË FUSHËS¹

nga Irena Islami, Përgjegjëse e Sektorit të Kërkimit Shkencor, pranë Departamentit të Kërkimit Shkencor dhe

Armanda Begaj, Departamenti i Kërkimit Shkencor, Zhvillimit dhe Teknologjisë së Informacionit, KLSH

Konferenca e Parë Shkencore e Kontrollit të Lartë të Shtetit u zhvillua në muajin dhjetor 2012 dhe iu kushtua tërësisht historikut të këtij institucioni të rëndësishëm kushtetues. Ajo përcolli mesazhin se formimi dhe ruajtja e

identiteteve të qarta historike të institucioneve kushtetuese i shërben rritjes së kujtesës institucionale, forcimit të Shtetit të së drejtës, si dhe kulturës së respektimit të institucioneve.

Konferenca e Dytë Shkencore, e zhvilluar në datat 12-13 dhjetor 2013, përcolli përjasjet dhe eksperiencat më të mira të auditimit suprem publik tek ne, të arritura gjatë një viti. Përafrimi i konkluzioneve të nxjerra nga puna praktike audituese dhe të përgjithësuara nën orientimet e standardeve të fushës, INTOSAI, rezultuan të suksesshme. Kumtesat e audituesve dhe menaxhereve të KLSH, ku ndër më kryesoret ishin ato për instrumentin e Vetë-Vlerësimit të Integritetit në një SAI, auditimi i jashtëm në një perspektive juridike, qasja e KLSH ndaj tatimpaguesve në rritjen e transparencës dhe qeverisjes së mirë, fuqizimi i rolit mbikqyres të KLSH në kushtet e krizës botërore ekonomike dhe financiare dhe Roli i KLSH në procesin e auditimit të administrimit fiskal, sollën mendimin e kualifikuar dhe profesional të stafit të këtij institucioni.

Ky mendim, i formuluar dhe i paraqitur sipas standardeve të kërkuara në konferenca të tilla dhe konkluzionet interesante e me vlerë, u pasuruan nga kumtesat dhe diskutimet e partnerëve të shumtë vendas dhe të huaj që morën pjesë dhe dhanë kontributin e tyre në konferencë. Me mjaft vlerë në ngritjen në një nivel të ri të mendimit auditues në vendin tonë ishin studimet dhe kumtesat e përfaqësuesve dhe profesionistëve të kontabilitetit shqiptar, të analizës së riskut dhe të matematikës së aplikuar, të mbrojtjes së mjedisit, etj si Prof. Dr. Jorgji Bollano, Prof. Dr. Skënder Osmani, Prof. Asoc. Dr. Hysen Çela, Prof. Asoc. Dr. Sazan Guri, etj., për dinamikat e sotme të raportimit financiar, për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe përdorimin e tyre në pasqyrat financiare të auditimit të sektorit publik, për auditimin dhe menaxhimin

e projekteve, për zbatimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve urbane, për një qasje të re në auditimin e investimeve publike, etj.

Kontributet e partnereve të huaj në konferencë ishin po ashtu shumë të rëndësishme, thelbësore dhe një vlerë e shtuar në karakterin shkencor të saj. Përfaqësues të lartë nga DG-Budget i BE-së, nga Gjykata Evropiane e Audituesve, nga SAI-t partnerë të KLSH-se, si Gjykata Turke e Llogarive, Zyra Kombëtare e Auditimit të Polonisë (NIK), Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë, Zyra e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës, Zyra Shtetërore e Auditimit të Maqedonisë, si dhe të përfaqësuesve të SIGMA përcollën eksperiencë, mendime dhe konkluzione të çmuara për përgjegjësinë e rritur menaxheriale, për rolin e standardeve ISSAI në përmbushjen e misionit të SAI-ve, për dobitë dhe modalitetet e bashkëpunimit mes audituesve të brendshëm dhe të jashtëm të sektorit publik, për metodën e re të kampionimit në auditimin e fondeve të BE, etj.

Ndër konkluzionet kryesore të Konferencës së Dytë Shkencore të KLSH ishte përfundimi se llogaridhenia menaxheriale, si përbërës thelbësor i mireqeverisjes dhe vendosja e “tone at the top” mund të sigurohen nëpërmjet transparencës së plote të veprimtarisë menaxheriale, delegimit të kompetencave dhe marrjes së informacionit. Një konkluzion tjetër shumë i rëndësishëm ishte se vetëm nëpërmjet auditimeve të pavarura dhe profesionale, KLSH mund të kontribuojë në mbajtjen e qëndrueshmërisë afatmesme dhe afatgjatë të financave publike të vendit, në mbrojtje të interesit publik dhe forcimit të qeverisjes kombëtare.

Po ashtu, studiuesit e ndryshëm pjesëmarrës në këtë konferencë theksuan se thellimi në analizën e riskut në planin vjetor të auditimeve dhe marrja e informacionit nga burime të ndryshme, përfshirë dhe shoqërinë civile dhe mediat, ndihmon në përzgjedhjen efektive të subjekteve dhe tematikave për

auditimin vjetor. Nga studiuësit e Gjykatës Turke të Llogarive doli konkluzioni se forcimi i rolit mbikëqyrës të auditimit publik suprem mbi financat shtetërore mund të realizohet me efektshmëri duke zbatuar në praktikë ISSAI-t e auditimit financiar, të përputhshmërisë dhe të performancës, në përshtatje të plote me kushtet e vendit. Përfaqësuesit e Institutit të Eksperteve Kontabël të Autorizuar, përcollën mendimin se rritja e cilësisë në auditimin e rregullave fiskale kontribuon në mirëfunksionimin e skemës së rregullatorit financiar në vend.

Një pohim tjetër thelbësor i konferencës ishte fakti që përballimi i sfidave të sotme në auditimin publik lehtësohet dukshëm nga një bashkëpunim konkret dhe në vijimësi i audituesve të brendshëm me audituesit e jashtëm, duke synuar ngritjen e këtij bashkëpunimi deri në nivelin e auditimeve të përbashkëta. Konferenca rekomandoi se instrumenti INTOSAINIT i vetëvlerësimit ndihmon rritjen e integritetit të SAI-t dhe forcon besueshmërinë e tij në publik, prandaj ai duhet të përdoret me shpesh nga KLSH.

Përfaqësuesi i Gjykatës Evropiane të Audituesve theksoi faktin se procesi i integritetit në BE kërkon njohjen e metodikave bashkëkohore të auditimit të fondeve të BE-së.

Të gjithë pjesëmarrësit arritën në konkluzionin se në kushtet e reja të krijuara, SAI-t, duke përfshirë edhe KLSH-në, duhet të rrisin përdorimin e mjeteve jo-konvencionale në politikat dhe planet e tyre audituese, duke bashkëpunuar më ngushtë dhe gjerësisht me botën akademike, shoqërinë civile dhe organizatat profesionale të fushës.

Gjatë vitit të ardhshëm, KLSH do të vijojë punën e tij në aplikimin e standardeve INTOSAI dhe disiplinës shkencore të auditimit suprem publik,

nëpërmjet shkëmbimit të hapur dhe intensiv të eksperiencave mes audituesve, me institucionet profesionale të fushës në vend dhe me partneret e huaj, nëpërmjet botimit të studimeve në revistën e tij shkencore “Auditimi Publik”, bashkëpunimit me Revistën “INTOSAI Journal”, pjesëmarrjes dhe prezantimeve në konferencat dhe seminarët e EUROSAI dhe INTOSAI, si dhe vijimit të botimeve të librave në serinë e *Botimeve KLSH 2014* dhe sigurisht edhe nëpërmjet Konferencës së Tretë Shkencore të tij që do të zhvillohet në shtator 2014.

ⁱ Botuar në Gazetën “Ekonomia” dt. 26 Dhjetor 2013